



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2021:188342

Datë: 10.01.2022

Numri i dokumentit: 02587775

**PPP.nr.36/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA NË ISTOG**, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit: F.F.C LLC me nr te biznesit... Rr. .... nr.. P. , kundër debitorëve: NPN L. me nr te biznesit ..... me seli në I. , përfaqësuar nga A. A. (kredi marrës) dhe A. A. nga Istogu me nr. Personal ..... (bashkë kredimarrës), për shkak të borxhit në shumë prej 35,237.84 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit te parë NPN L. me dt.30.07.2021, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.10.01.2022 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit NPN L. me nr te biznesit .... me seli në I., ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarim P.nr.467/2021 të dt.16.07.2021, sipas propozimit të kreditorit F.F.C LLC me seli në P. .

**A r s y e t i m**

Kreditori F.F.C LLC me nr te biznesit .... Rr..... nr. P. , ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorëve: NPN L. me nr te biznesit ... me seli në I., përfaqësuar nga A.A. (kredi marrës) dhe A.A. nga I. me nr. Personal .... (bashkë kredi marrës), si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguajnë borxhin në shumë prej 35,237.84 €, te gjitha këto ne afat 7 ditor nga dita e pranimit te urdhrit, ne të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimimi i sendeve te lëna peng sipas listës se pengut dhe t'i dorëzohen kreditorit për shitje, që të realizoj kërkesën e tij ndaj debitorëve, të gjitha këto të specifikuar ne propozimin për përmbarim te dt. 16.07.2021.

Përmbaruesi privat me urdhrin përmbarimit P.nr.467/2021 të dt.16.07.2021, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Debitori i parë NPN L. me nr te biznesit .... me seli në I. , përfaqësuar nga A. A. (kredi marrës), brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrit përmbarimor, me te cilin ka kërkuar qe të aprovohet i njëjti si i bazuar, të hedhet urdhri përmbarimor si dhe të kompensohen shpenzimet e procedurës përmbarimore me arsyetimin se kreditori nuk ka dërguar shumën reale dhe vlera e propozuar nuk korospondon me pagesat e kryera nga kompania jonë, pasi qe ne kemi paguar shumën dhe atë te borxhit kryesor prej 14.170 €, kostos administrative dhe ne emër te interesit kemi paguar totalin prej 28,900 €. Me tutje debitori i parë shton se kompania jonë është reflektu direkt nga pandemia dhe ne fillim te vitit 2020 jemi futur ne regresion si kompani ku çdo planifikim pune na është bllokuar, kemi tentuar disa herë qe te kontaktojmë me kreditorin qe të na mundësoj ristrukturimin e kredisë por nuk e kanë marr për bazë dhe as qe na kanë takuar stafi i kreditorit, qe të na epet kjo mundësi, ku kredia ka qenë aktive dhe ne kornizën e aftit te pagesave deri me 0509.2020 por se na është privuar kjo e drejt elementare, po ashtu ne kurrë nuk e kemi pranuar dhe as nënshkrua planin e pagesave e cila është obligative me rastin e nënshkrimit te marrëveshjes se kredisë.

Me tutje debitori i parë shton se takimi i par me insistimin e neve si debitor është realizuar me dt. 12.07.2021 dhe na është thënë se tani është vonë për çdo kërkesë, edhe pse na ishim ata qe kërkonim te drejtën ligjore dhe mundësinë ma të mirë te neve si palë, andaj kërkojmë qe të hapet seancë lidhur me prezantimin e provave dhe fakteve dhe kërkesave si dhe të na mundësohet ekspertizë financiare te kësaj kredie e cila nuk korrespondon me marrëveshjen kredituese, planin e pagesave dhe pagesave te kryera nga ne si debitorë.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori i parë, kreditori ka paraqitur përgjigje në në të njëjtin me kërkesë qe të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar me arsyetimin se i njëjti është paraqitur vetëm për ta zvarritur procedurën dhe nuk është mbështetur ne asnjë provë, ku ne kemi pasur takim e te shumta me debitorin por i njëjti gjithmonë ka kërkuar afat shtesë duke përfituar ne kohë por asnjë herë qe te beje zgjidhje për pagesën e obligimit.

Gjykata Themelore në Peje- Dega ne Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorëve në prapësim kur thirren ne atë se kreditori nuk ka dërguar shumën reale dhe vlera e propozuar nuk korospondon me pagesat e kryera nga kompania jonë, pasi qe ne kemi paguar shumën atë te borxhit kryesor prej 14.170 €, kostos administrative dhe ne emër te interesit kemi paguar totalin prej 28,900 €, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si te pa bazuara dhe atë duke u bazuar ne nenin 7 par.1 te LPK-së i cili nen parasheh se “Palët kanë për detyrë te paraqesin te gjitha faktet mbi te cilat i mbështesin kërkesat e

veta”, e ne rastin konkret debitori në prapsim përveç pretendimeve nuk ka ofruar asnjë provë te vetme që do të dëshmonte te kundërtën e asaj që kreditori ka kërkuar ne propozimin për përmbarim.

Po ashtu sa i përket pretendimeve e debitorit lidhur me pandeminë dhe pamundësinë e kreditorit që të behet shtyrja e kredisë sipas vendimit të qeveris, si dhe sa mi përket asaj se nuk e kemi pranuar dhe nënshkruar planin e pagesave, te njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si te pa bazuara pasi që ne shkresa te lendes nuk ka dëshmi që debitori ka kërkuar nga kreditori që të shtyhen kështu e kredisë si pasojë e pandemisë, ku debitori është dashur që të bëjë kërkesë që të i mundësohet një gjë e tillë nga ana e kreditorit, po ashtu nuk ka dëshmi që keni kërkuar planin e pagesave edhe pse ne nenin 3 pika. 2 dhe nenin 4 te kontratës se kredisë nr.575 te dt. 01.09.2016 është paraparë afati i kthimit te kredisë si dhe mënyra e kthimit te kredisë.

Për me tepër gjykata sqaron faktin se me rastin e nënshkrimit te kontratës se kredisë si dhe kontratës se pengut, kanë lindur te drejta dhe obligime ne mes palëve kontraktuese, të cilat kanë qenë të obliguara të dy palët ti respektojnë, ku kredi dhënësi i ka lëshuar kredinë në shumë prej 50.000 €, ndërsa kredi marrësi dhe bashkë kredi marrësi kanë qenë të obliguar kthimin e kredisë në një periudhën kohore prej 48 muajve, dhe në rast të mos respektimit të kushteve te kontratës secila nga palët ka pasur të drejtë që të inicioj procedurë gjyqësore për mos zbatim të dispozitave kontraktuese, e në rastin konkret debitorët kur nuk kanë bërë pagesat sipas marrëveshjes, atëherë janë shkelur nenet e kontratës dhe janë shkaktuar pasoja juridike ne dëm te kreditorit, e ne rastin konkret debitorët si shkelës të kontratës kanë obligim pagesën te cilën e kërkon kreditori ne këtë çështje juridike-përmbarimore, e duke u bazuar ne nenin 245 par.1 te LMD-së i cili nen parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorëve të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjithashtu neni 249 par.1 te LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t`i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t`i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitorët shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Kurse sa përket kërkesës që te hapet seancë që te paraqiten faktet, gjykata nuk e pa te arsyeshme që te hapet seancë pasi që ne shkresa te cilët gjinden ne

lëndë ka prova te mjaftueshëm qe te vendoset si ne dispozitiv te këtij aktvendimi, shtuar faktin se ne bazë te nenit 69 par.4 parashihet se “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së dhe LPK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 22 par. 1.9, 36, 38, 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, 249 par. 1 dhe 2, dhe neni 382 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me nenin 7 par.1 te LPK-së, e në lidhje me Marrëveshjen mbi kredinë me nr. 575 te dt. 01.09.2016 dhe kontratën e pengut e dt. 01.09.2016, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.36/2021, dt.10.01.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.